

1 E mërkurë, 1 prill 2026

2 [Seancë e hapur]

3 [Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen]

4 [Të akuzuarit Thaçi, Kilaj dhe Fazliu u

5 paraqitën përmes videolidhjes]

6 [Të akuzuarit Smakaj dhe Kuçi nuk u paraqitën]

7 --- Seanca fillon në orën 14.01

8 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Sekretare, ju lutem,

9 paraqisni lëndën.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve.

11 Kjo është çështja KSC-BC-2023-12, Prokurori i Specializuar

12 kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil

13 Fazliut dhe Hajredin Kuçit.

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju lutem ekipeve të

15 prezantohen duke filluar nga Prokuroria.

16 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëdita, Josh Hafetz, përfaqësues

17 i Prokurorit të Specializuar. Këtu kam kolegët e mi, z.

18 Sullivan, Hicks, Line Pedersen dhe Palsenberg.

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mbrojtja. Znj. Menegon.

20 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mirëdita, unë jam këtu me Lea

21 Allix, Lirim Greicevci edhe një ekip tjetër që përfaqëson --

22 Pranvera Haxhiaj, që përfaqëson Mbrojtjen e z. Thaçi.

23 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Rees, që po na ndjek

24 përmes Zoom-it.

25 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë jam me

1 bashkëmbrotjës in këtu, Huw Bowden, dhe Muharrem Halilaj.

2 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Holmes.

3 Z. HOLMES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mirëdita të  
4 gjithëve, unë jam përmes videolidhjes me kolegen time Soliman,  
5 kam edhe kolegët e tjerë që na përfaqësojnë në sallën e  
6 gjyqit.

7 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Young.

8 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mirëdita të  
9 gjithëve, edhe unë përfaqësoj z. Fazliu përmes videolidhjes.  
10 Kam këtu znj. Beqiri që na ndjek po ashtu përmes videolidhjes  
11 edhe unë po ashtu jam përmes videolidhjes.

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Admiraal.

13 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Unë jam këtu vetëm në sallën e  
14 gjyqit.

15 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Shoh që z. Thaçi, z. Kilaj  
16 dhe z. Fazliu po na ndjekin po ashtu përmes videolidhjes. Z.  
17 Smakaj dhe z. Kuçi nuk po e ndjekin këtë seancë pasi kanë  
18 hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë sipas Rregullores,  
19 rregulla 96(2) (c).

20 Jemi këtu për seancën përgatitore të Mbrojtjes, që si  
21 rregull duhet bërë përpara se të fillojë Mbrojtja me  
22 paraqitjen e provave të veta në bazë të rregullës 119(3). Kjo  
23 është në vijim të mbylljes të provave prej Prokurorisë më 13  
24 mars 2016, e mbështetur në parashtrimin e protokolluar 792.

25 Po atë ditë unë lëshova edhe urdhrin për planifikimin e

1 seancave, me numër 790, dhe caktova datën 24 prill 2026 si  
2 afatin e fundit për Mbrojtjen për dorëzimin e provave  
3 materiale dhe listës së dëshmitarëve, por sigurisht ju dhashë  
4 mundësinë që të japin materiale shtesë deri sot, 1 prill 2026,  
5 por të japin dhe arsyet e vlefshme për këtë. Po ashtu caktova  
6 periudhën 7 deri 24 prill si periudhën për Mbrojtjen që të  
7 paraqesë provat e veta, e cila më pas u zgjat me email deri më  
8 28 prill 2026.

9 Vërej që Smakaj, Fazliu dhe Kuçi, ekipet e tyre përkatëse  
10 kanë dorëzuar njoftimet përkatëse ku na kanë njoftuar se nuk  
11 do të paraqesin dëshmitarë. Ju lutem të më konfirmojë  
12 gjithsecili duke filluar me ju, z. Holmes, a konfirmoni se nuk  
13 do të dorëzoni kërkesë -- më falni, jo, jo z. Holmes, z.  
14 Young, pra, konfirmoni që nuk do të kërkonit të dorëzoni  
15 parashtrime plotësuese?

16 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po, e  
17 konfirmoj.

18 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. Rees, po ju do të dorëzoni informacion shtesë sot?

20 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Jo, nuk  
21 ndryshojmë asgjë, qëndrimi ynë mbetet i njëjtë.

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Admiraal.

23 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] As ne nuk do të dorëzojmë asgjë  
24 shtesë sot.

25 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Young, në paragrafin 2

1 të parashtrimit tuaj thoni që keni të drejtën për të bërë një  
2 parashtrim gjatë fjalëve hyrëse dhe përmbyllëse. Mesa kuptoj  
3 unë ju doni të mbani një fjalë gjatë deklaratave përmbyllëse,  
4 apo jo? E kam kuptuar drejtë? Ju nuk do të mbani fjalë hyrëse  
5 pa pasur prova, apo jo?

6 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] I nderuar  
7 Gjykatës, unë do të kem një fjalim përmbyllës nëse më lejoni.  
8 Pra, nuk do të ketë prova, por unë do të doja të kisha një  
9 fjalë përmbyllëse nëse më lejohet, dhe mendoj që do më zgjasë  
10 rreth 45 minuta ky fjalim.

11 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mendoj se Gjykata në këtë  
12 rast mendon se deklarata hyrëse lejohet vetëm kur paraqiten  
13 prova, përndryshe duhet të keni vetëm fjalën përmbyllëse. E  
14 kuptoj që ju pajtoheni me këtë, apo jo?

15 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po, po, kështu  
16 e kam kuptuar dhe unë. Unë në Angli jam mësuar, dhe në Uells  
17 jam mësuar që ne zakonisht të kemi fjalë përmbyllëse, dhe jo  
18 fjalë hyrëse, kështu që për mua kjo është krejt okej.

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Holmes, shoh që keni  
20 paraqitur katër dëshmitarë në emër të z. Kilajt, të cilët janë  
21 pranuar përmes rregullës 153. A mund të konfirmoni se nuk do  
22 të shtoni dëshmitarë në listën tuaj?

23 Z. HOLMES: [Përkthim] Po, kështu është. Është e saktë.

24 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

25 Znj. Menegon, ju keni renditur vetëm një dëshmitar në

1 emër të z. Thaçi, DHT01. Ju lutem, a mund të më informoni nëse  
2 do të kërkonte të dorëzoni parashtrim shtesë për këtë dëshmitar  
3 sot?

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo për momentin. Faleminderit.

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Menegon, cili është  
6 parashikimi juaj aktual për deklaratën hyrëse në emër të z.  
7 Thaçi?

8 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Duke mbajtur parasysh që ne nuk  
9 kemi plan të thërrasim dëshmitarë në këtë fazë, preferojmë po  
10 ashtu që parashtrimet tona t'i bëjmë në fazën përmbyllëse të  
11 provave.

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit për  
13 informacionin që na dhatë.

14 Tani dua t'i drejtohem Prokurorisë të pyes nëse kanë  
15 ndonjë koment për momentin sa i takon parashtrimeve të  
16 Prokurorisë -- më falni, të Mbrojtjes, në bazë të rregullës  
17 119.

18 Z. HAFETZ: [Përkthim] Varet se si do të jetë zhvillimi i  
19 sotëm, por ne do t'ju japim përgjigje nesër me shkrim sikurse  
20 ju kemi njoftuar sa i takon mocioneve sipas 153, ne kemi  
21 diskutuar me Mbrojtjen e z. Kilaj sa i takon fakteve të  
22 mundshme për të cilat jemi të pajtuar dhe do të dorëzojmë një  
23 mocion tjetër në bazë të rregullës 153, pasi na zgjatët  
24 afatin, dhe do ta bëjmë këtë javën tjetër.

25 Dy prej raporteve që janë në provat e z. Thaçi në pamje

1 të parë duket sikur janë aktekspertiza dhe nuk është bërë  
2 asnjë njoftim sipas rregullës 149 dhe nuk e kuptojmë kush  
3 është dëshmitari që bashkëshoqëron këtë raport në *Legal*  
4 *Workflow*. Pra, nëse i kundërshtojmë këto raporte dhe nëse  
5 gjykojmë që nuk ka bazë që të pranohen raportet, nuk po them  
6 që nuk ka për momentin, por nëse nuk do të ketë bazë për këto  
7 raporte, atëherë ngrihet pikëpyetja nëse do të propozojnë një  
8 dëshmitar dhe për këtë s'kemi dëgjuar asgjë. Dhe nëse do të  
9 ishte dëshmitar ekspert, sigurisht duhet të respektohet  
10 rregulla 149 edhe urdhri për zhvillimin e procesit gjyqësor që  
11 kërkon kohë.

12 Megjithatë, përveç kësaj nuk kam asgjë për të shtuar.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Para se t'i drejtohem znj.  
14 Menegon sa i takon këtij komenti që sapo bëtë ju, kur thoni që  
15 periudha kohore sipas 149-s do të jetë më e gjatë, a mund të  
16 ma shtjelloni çfarë doni të thoni me këtë që kërkon kohë, dhe  
17 sipas jush cila është periudha e duhur kohore?

18 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po. Sipas rregullës 149 duhet të  
19 njoftohemi 30 ditë më përpara nëse kemi dëshmitarë ekspertë  
20 dhe aktekspertizë. Unë thjesht doja të thoja që ne nuk kemi të  
21 qartë për momentin dhe ne do ta kundërshtojmë në bazë të  
22 themelësisë së parashtrimit që do të bëjë Mbrojtja, kuptohet.

23 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Siç e kam kuptuar unë - dhe  
24 mund të më korrigjoni - është që periudha kohore, sipas  
25 rregullës 149 është shtatë ditë, jo 30 ditë përpara se të vijë

1 dëshmitari në sallën e gjyqit apo dhe shtatë ditë për të  
2 ngritur një kundërshtim, që do të thotë se është më pak se  
3 periudha që është përcaktuar në Urdhrin për Zhvillimin e  
4 Procesit Gjyqësor, sigurisht në vartësi të informacioneve  
5 plotësuese që jepen, prandaj isha shumë kurioz për këtë  
6 dallimin që kemi ne të dy sa i takon periudhës kohore për të  
7 bërë njoftimin përkatëse.

8 Z. HAFETZ: [Përkthim] Më falni se nuk e kam përpara, por  
9 më duket se në Urdhrin për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor,  
10 paragrafi 35, thotë që duhet të njoftohemi 30 ditë më përpara  
11 në qoftë se do të thërritet dëshmitar ekspert.

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull.

13 Znj. Menegon, keni ndonjë koment ju lidhur me materialet  
14 që janë në listën tuaj?

15 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] ne do ta dorëzojmë, në fakt,  
16 raportin sipas rregullës 138 sikurse ka bërë dhe ZPS-ja me  
17 raportet e veta. Sa i takon njoftimit 30 ditor, ne pikërisht  
18 për këtë arsye vendosëm të mos e thërrasim dëshmitarin sepse  
19 raportin e morëm shumë vonë.

20 Por, nëse nuk do të pranohet pranimi i këtyre raporteve,  
21 atëherë ne do të kërkojmë leje që të kërkojmë pranimin e  
22 raportit përmes rregullës 149 dhe ta thërrasim dëshmitarin  
23 nëse lind nevoja. Ne nuk kemi shtuar asnjë dëshmitar në listën  
24 tonë për momentin sepse gjykojmë që raporti sipas rregullës  
25 138 është i mjaftueshëm. Por ne mund të bëjmë dhe parashtrim

1 me shkrim në lidhje me këtë aspekt nëse është e nevojshme.

2 Faleminderit.

3 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po kjo ndikon planifikimin  
4 tonë, në fakt, sepse nëse do të duhet të presim për mocionet e  
5 provave jогоjore që të dorëzohen dhe pastaj të dalë vendimi,  
6 dhe vetëm pas kësaj mund të bëhet kërkesa sipas rregullës 149,  
7 por kjo mund ta shtyjë procesin sepse ju mund të dorëzoni  
8 mocion sipas rregullës 149 dhe njëkohësisht të dorëzoni  
9 materialet përmes mocioneve të provave jогоjore.

10 A nuk është kjo diçka që do të ishte e volitshme? Dhe veç  
11 kësaj nuk do të ishte e padëgjuar që të kërkohet ndryshimi i  
12 afatit kohor që është përcaktuar në vendimin në Urdhrin për  
13 Procesin -- për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor?

14 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Në Çështjen 06 një prej palëve,  
15 në fakt, e vendosi dëshmitarin në listën e dëshmitarëve, ishte  
16 dëshmitar ekspert dhe njëkohësisht kërkoi të pranohej raporti  
17 me shkrim, dhe në atë rast Trupi Gjyqësor e rrëzoi kërkesën.  
18 Këtë e kemi si precedent. Pra, nëse vendosim në listën e  
19 dëshmitarëve, atëherë mendojmë që raporti mund të mos jetë më  
20 i pranueshëm, kështu që ne vendosëm që të ndjekim këtë rend.

21 Gjithashtu dua të shtoj, ne u konsultuam me një nga  
22 dëshmitaret e mundshme sa i takon disponueshmërisë së saj dhe  
23 na tha që nuk do të jetë e lirë deri në datën 8 maj, prandaj  
24 dhe ne vendosëm, në fakt, që do të ishte më mirë që të  
25 dorëzonim raportin.

1 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mbase mund të jetë e  
2 parakohshme të pyes Prokurorin tani, por meqë keni marrë  
3 njoftimin më 27 mars për dokumentin që është i Mbrojtjes së  
4 Thaçit dhe është një dokument që është një raport që mund të  
5 kërkohet të pranohet si aktekspertizë, do ta pranoni ju  
6 atëherë që ta llogarisim kohën që nga data 27 mars?

7 Z. HAFETZ: [Përkthim] Kjo varet nëse flasim -- duhet të  
8 dimë cili është dëshmitari, duhet të përgatitemi. Do  
9 analizojmë materialin për këtë ekspert. Dhe materialet që  
10 përmenden në një prej raporteve, pa hyrë në detaje, mos t'i  
11 hymë ligjit dhe interpretimit të ligjit, por materialet në  
12 këto raste mbivendosen dhe me provat që sapo ka dorëzuar  
13 Mbrojtja dhe që janë pranuar disa syresh në këtë çështje  
14 gjyqësore.

15 Pra, ka punë, ka pak punë me këtë raport. Prandaj kam  
16 kuptuar unë që -- prandaj janë parashikuar rregulla përkatëse  
17 në urdhrin përkatëse.

18 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po për Dëshmitarin DHT-01  
19 si mendon Prokuroria, duhet t'i bëni kundërpyetje? Doni që  
20 dëshmitarin ta dëgjojmë në sallën e gjyqit apo ju mendoni që  
21 dëshmia e këtë dëshmitari nuk është relevante dhe nuk ka  
22 nevojë të merret në formë gojore?

23 Z. HAFETZ: [Përkthim] Unë do të doja t'i përgjigjesha  
24 tani kësaj pyetje, por po flasim për një dëshmitar që flet për  
25 shumë transkripte që kanë qenë objekt i procesit të

1 verifikimit që janë po ashtu objekt e një dëshmitari tjetër,  
2 prandaj kjo kërkon shumë analizë përpara se të përgjigjem nëse  
3 është relevant ky dëshmitar apo jo, apo nëse, si alternativë,  
4 ky person të vijë këtu dhe ne t'i bëjmë pyetjet përkatëse.

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju pyeta sepse dëshmitari  
6 DHT-01 është i vetmi dëshmitar që mund të japë dëshmi edhe për  
7 të cilin janë dorëzuar materialet, edhe teorikisht mund të  
8 jetë një dëshmitar që do të dëgjohet në sallën e gjyqit,  
9 gjithmonë në rast se Gjykata vendos që dëshmitari duhet të  
10 japë dëshmi gojore dhe duhet t'i bëhen kundërpvetjet  
11 përkatëse.

12 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dëshmitari është i disponueshëm.  
13 Datën duhet ta konfirmoj, por është në listën tonë. Dhe nëse  
14 na rrëzohet mocioni sipas rregullës 153 atëherë ne do të donim  
15 që të kishim mundësi që ta pranohim provën e tij përmes një  
16 rregulle tjetër. Faleminderit.

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Që ta kuptoj unë qartë, për  
18 momentin nuk ka asnjë dëshmitar për të dhënë dëshmi gojore nga  
19 ekipet e Mbrojtjes në sallën e gjyqit, dhe i vetmi dëshmitar -  
20 - dhe i vetmi përjashtim i mundshëm për momentin është në  
21 qoftë se do të rrëzohet mocioni sipas rregullës 153 për  
22 dëshmitarin 01. Vetëm në këtë rast dëshmitari do të vijë  
23 fizikisht në sallën e gjyqit. A e kam kuptuar unë drejt?

24 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kjo është  
25 mundësi. Megjithatë, ZPS-ja ka dorëzuar transkriptin dhe

1 përkthimin përkatës mbështetur në rregullën 138 pa thërritur  
2 asnjë zbardhës apo asnjë përkthyes, kështu që ne mendojmë që  
3 rregulla 138 do të duhet të shikohet, domethënë, për sa i  
4 takon mundësisë së thërritjes së këtij dëshmitari për të dhënë  
5 dëshmi në sallën e gjyqit apo jo.

6 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Nuk e kisha për  
7 themelësinë, nuk po e bëja këtë pyetje për të ditur nëse ka  
8 themel apo jo thirrja e këtij dëshmitari, por thjesht doja të  
9 dija në qoftë se duhet të planifikojmë ndonjë datë në Gjykatë  
10 në mënyrë të tillë që të dëshmitari të vinte në sallën e  
11 gjyqit. Për këtë arsye jua bëra pyetjen. Dhe duket sikur në  
12 mënyrë që të zgjidhim çështjen ose problemin që ka të bëjë me  
13 rregullën 153, kjo nuk mund të ndodhi javën e datës 7 prill.  
14 Ndoshta mund të ndodhë një javë më pas.

15 Dua t'ju pyes në qoftë se dëshmitari është disponueshëm  
16 apo jo javën pas 7 prillit.

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Do të duhej që ta pyes. Me thënë  
18 të drejtën do e vlerësoja shumë në qoftë se ju do planifikonit  
19 ndonjë datë për sa i takon dëshmisë së këtij dëshmitari dhe  
20 duke marrë parasysh parashtrimet e Prokurorisë. Megjithatë, në  
21 qoftë se ne vendosim që të dorëzojmë dëshminë e këtij  
22 dëshmitari për t'u pranuar me shkrim, dhe në qoftë se kjo  
23 kërkesë rrëzohet, do ju kërkonim që të pranoni kërkesën tonë  
24 që ky dëshmitar të japë dëshmi përmes videolidhjes se do ishte  
25 më e thjeshtë për të gjithë ne kjo.

1 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Për momentin  
2 duket sikur ka pak vështirësi që nëse raportet e përmendura si  
3 raporte që potencialisht mund të pranohen sipas rregullës 138,  
4 në fund nuk pranohen mbi këtë bazë ligjore dhe ju kërkoni që  
5 këto materiale më pas të pranohen si aktekspertiza të  
6 ekspertit ose dëshmitarit. Dhe ju thatë që kjo është arsyeja  
7 që pse ju nuk doni ta bëni kërkesën mbi bazën e rregullës 138.  
8 Megjithatë, sikurse e thashë dhe më përpara është e vështirë  
9 për mua që ta kuptoj se pse do ishte ky përfundimi, në  
10 veçanti, duke pasur parasysh diskutimin që po bëjmë tani dhe  
11 qëllimi është që ta përshpejtojmë procesin sa më shumë të jetë  
12 e mundur, në kuptimin që dëshmitari që ju dëshironi të  
13 thërrisni të merret në pyetje sa më shpejt të jetë e mundur.

14 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Nëse ju, i nderuar Gjykatës, na  
15 kërkoni ne që të dorëzojmë një parashtrim mbështetur mbi  
16 rregullën 159, që është rregulla alternative, dhe në qoftë se  
17 ju konfirmoni që kjo nuk ka ndikim mbi mocionin sipas  
18 rregullës 138, mund ta bëjmë dhe mbi këtë bazë ligjore, në  
19 qoftë se na e konfirmoni këtë gjë. Për ne nuk është problem.

20 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Megjithatë do të duhej që  
21 të pyes Prokurorinë së pari. Prokuroria a është kundër këtij  
22 shpjegimi, domethënë, me fjalë të tjera, që të bëhet njoftimi  
23 sipas rregullës 149(1) menjëherë dhe kjo gjë të mos ketë  
24 ndikim sa i takon pranimit të raportit përmes provave  
25 jогоjore? A ka ndonjë kundërshtim Prokuroria lidhur me këtë?

1 Z. HAFETZ: [Përkthim] E kuptoj, i nderuar Gjykatës, e  
2 kuptoj situatën.

3 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po, dhe jeni i gatshëm që  
4 të pranoni që kjo nuk do të ketë ndikim mbi kërkesën për  
5 pranimin in e provave jогоjore, apo jo?

6 Z. HAFETZ: [Përkthim] Duket sikur kjo është mënyra e  
7 drejtë për të vijuar më tej, domethënë që të bëhet njoftimi i  
8 duhur në mënyrë të tillë që të kemi proces më të shpejtë. Nuk  
9 mendoj që kjo e zgjidh problemin e thirrjes së dëshmitarit ose  
10 kohës që do të duhet të thërritet dëshmitari, në qoftë se  
11 ndodh kjo, megjithatë e kuptoj.

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po, por nga ana tjetër kemi  
13 afatin 30-ditor dhe kemi gjithashtu dhe afatin që kemi  
14 paracaktuar sa i takon përfundimit të dëgjimit të dëshmive të  
15 dëshmitarëve të ekipeve të Mbrojtjes që është më pak se 30  
16 ditë. Dhe kjo në vetvete përbën problem.

17 Megjithatë, ajo çfarë do sugjeroja unë duke pasur  
18 parasysh bisedat dhe diskutimet e palëve është që të bëhet  
19 njoftimi sipas rregullës 149. Pra, ju lutem, bëjeni këtë  
20 njoftim menjëherë.

21 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Do ta bëjmë.

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Gjykata duket sikurse ka  
23 pas gjasa të ketë seancë me datën -- domethënë, në javën e  
24 datës 7 prillit sepse nuk duket sikur ka një dëshmitar që do  
25 të mund të mund ta thërrasim në atë javë.

1 Dhe znj. Menegon do të duhet të sqarojë diçka tjetër  
2 përpara se të vazhdoj më tej. Nëse ndonjë prej materialeve të  
3 cilat tani konsiderohen si të dorëzuara mbështetur në  
4 rregullin 153 ose 138, pra, nëse këto materiale pranohen me  
5 shkrim, a dëshironi që të bëni një deklaratë hapëse apo jo?

6 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Në qoftë se të gjitha materialet  
7 do të pranohen me shkrim neve nuk kemi se pse të bëjmë një  
8 deklaratë me shkrim, domethënë, deklaratë të hapur, hapëse.

9 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po në qoftë se materialet  
10 nuk pranohen me shkrim, domethënë, në qoftë se do të duhet që  
11 të parashtroni këtu në sallën e gjyqit, në atë rast ju do të  
12 doni që të bëni deklaratë hapëse?

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Në qoftë se ju do vendosni që  
14 dëshmitari të japë dëshmi në gjyq, atëherë ka kuptim për neve  
15 që të bëjmë deklaratat hapëse nga ana jonë, pra si ekip i z.  
16 Thaçi.

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Do bëjmë një pushim të  
18 shkurtër tani në mënyrë të tillë që të vlerësoj pak se çfarë  
19 urdhri gojor mund të jap, duke pasur parasysh diskutimet që u  
20 bënë këtu në sallën e gjyqit.

21 Megjithatë, përpara sesa të bëj pushimin, dëshiroj që të  
22 trajtojmë një tjetër çështje që është pranimi ose prania e të  
23 akuzuarve gjatë prezantimit të argumenteve të ekipeve të  
24 Mbrojtjes.

25 Vërej që z. Fazliu ka bërë një kërkesë në parashtrimin

1 804 të datës 23 mars 2026, që të marrë pjesë përmes  
2 videokonferencës në seancat e gjyqit, mbështetur në rregullin  
3 68(2).

4 ZPS-ja çfarë qëndrimi ka lidhur me këtë kërkesë?

5 Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk kemi asnjë  
6 qëndrim për momentin.

7 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Atëherë, ky  
8 është urdhër me gojë që ka të bëjë me këtë kërkesë.

9 Mendimi im është që për sa i takon pranisë fizike të të  
10 akuzuarve gjatë argumenteve të Mbrojtjes më shumë rëndësi ka  
11 që ata të jenë fizikisht të pranishëm në sallën e gjyqit. Dhe  
12 duke marrë parasysh, në veçanti, kërkesën e z. Fazliu si dhe  
13 qëndrimin e Prokurorisë, unë megjithatë e pranoj kërkesën e z.  
14 Fazliu, që është parashtrimi F00804, që të marrë pjesë në  
15 fazën e procesit gjyqësor të ekipeve të Mbrojtjes, pra,  
16 dëshmitarëve të Mbrojtjes përmes videolidhjes, në pajtim me  
17 rregullën 68(2).

18 Zyra Administrative kërkohet që të lehtësojë pjesëmarrjen  
19 e z. Fazliu.

20 Ky është fundi i urdhrit me gojë.

21 Gjithashtu dëshiroj të them që në qoftë se të akuzuarit e  
22 tjerë kanë kërkesa të ngjashme, unë jam i hapur për t'i marrë  
23 këto kërkesa. Dhe po ashtu kjo përbën një ndryshim të afateve  
24 të kërkesave të tilla ndryshe sa ç'është përcaktuar në  
25 Vendimin për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor.

1 Atëherë do të bëjmë një pushim të shkurtër më pak se 10  
2 minuta, kështu që do ju kërkoja që të rrinit aty ku jeni,  
3 domethënë, brenda sallës së gjyqit dhe përpara, do të fillojmë  
4 përsëri.

5 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Përpara sesa të  
6 ngriheni --

7 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po, po, z. Rees, vazhdoni.

8 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ju kërkoj  
9 ndjesë që nuk do jem i pranishëm kur të ktheheni përsëri në  
10 seancë sepse z. Bowden do jetë këtu dhe do të përfaqësojë  
11 interesat e z. Smakaj, por unë vetë duhet të largohem. Ju  
12 kërkoj ndjesë për këtë.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit për njoftimin.

14 Në rregull atëherë do bëjmë një pushim të shkurtër.

15 --- Seanca ndërpritet në orën 14.29

16 --- Seanca rifillon në orën 14.41

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Duke marrë parasysh  
18 parashtrimet që dëgjuam në sallën e gjyqit sot, dhe  
19 parashtrimet përkatëse të marra sipas rregullës 119, është e  
20 qartë se nuk ka dëshmitarë për t'u dëgjuar të paktën javën që  
21 fillon me 7 prill 2026.

22 Dëshmitari tjetër i cili mbase do të duhej që të vijë në  
23 sallën e gjyqit dhe për të cilin do planifikohet një datë  
24 seance këtu në sallën e gjyqit është Dëshmitari DHT-01,  
25 megjithatë, kjo do të varet nga rezultati i kërkesës mbi bazën

1 e rregullës 153 që do të duhet -- do të dorëzohet pikësëpari  
2 pastaj do të merret vendimi lidhur me të.

3 Do i kërkoj palëve tani që të jenë të disponueshme për  
4 datën 14 dhe datën 15 prill për seancën e mundshme të këtij  
5 dëshmitari, që është Dëshmitari DHT-01. Përsëri, dua t'ju them  
6 që kjo varet nga rezultati i pranimit të kërkesës mbi bazën që  
7 153, domethënë, në qoftë se do të pranohet me shkrim dëshmia e  
8 këtij dëshmitari apo jo.

9 Kjo është çështja e parë që doja të sqaroja. Palët  
10 udhëzohen të jenë të disponueshme në javën e 14 dhe 15 prillit  
11 për të dëgjuar këtë dëshmitar në qoftë se do të miratohet  
12 dëshmia e tij në sallën e gjyqit.

13 Aspekti i dytë, dhe ky është një urdhër me gojë, Mbrojtja  
14 e Thaçit do të dorëzojë kërkesa që lidhen me rregullën 149  
15 deri nesër në orën 4.00 pasdite. Kjo kërkesë duhet të  
16 përfshijë një shpjegim se pse kërkesa nuk është dorëzuar sot,  
17 deri sot në orën 4.00, që sipas Gjykatës kjo është -- ky është  
18 afati që duhet që të ishte respektuar, dhe pavarësisht  
19 shpjegimeve që na u dhanë sot, pra, është e rëndësishme që në  
20 kërkesën që do të dorëzohet nesër të bëhen shpjegimet  
21 përkatëse në parashtrimin me shkrim që do të bëjë Mbrojtja e  
22 Thaçit deri nesër në orën 4.00.

23 Kjo përfundon urdhrin tim me gojë.

24 Megjithatë, përtej kontekstit të urdhrit, do i kërkoj  
25 ekipit të Thaçit që të jetë sa më konkret të jetë e mundur në

1   parashtrimin në fjalë, pra, të japë sa më qartë aspektet e  
2   kohës kur dëshmitarët mund të vijjnë të japin dëshmi në qoftë  
3   se ato kategorizohen si dëshmitarë ekspertë, domethënë, kur  
4   janë të disponueshëm për të dhënë dëshmi, kjo është e para;  
5   dhe e dyta, në qoftë se ato do të paraqiten brenda 30 ditëve  
6   duhet që të jepet shkak i duhur i përligjur për të shkurtuar  
7   afatet e parashtruara në Urdhrin për Zhvillimin e Gjykimit.  
8   Dhe përveç kësaj, në qoftë se ata do të dëgjohen pas datës 28  
9   prill, do të duhet që të jepen shkaqet e përligjura apo  
10  justifikimet e ndryshimit të kalendarit që është miratuar.

11         A ka ndonjë aspekt tjetër që palët dëshirojnë të ngrenë?

12         Z. HOLMES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] A mundem unë  
13  të them diçka?

14         GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po.

15         Z. HOLMES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Faleminderit  
16  që më dhatë fjalën.

17         Sikur mund ta keni vërejtur, i nderuar Gjykatës, ne kemi  
18  dorëzuar mocione për pranimin e katër dëshmitarëve mbështetur  
19  në rregullën 153; domethënë, janë dëshmi që ne kërkojmë që të  
20  pranohen si prova jогоjore, pra si prova me shkrim. Pra, këto  
21  janë persona të cilët njihen mirë, kanë reputacion të  
22  padiskutueshëm dhe që ata mund të flasim për sa i takon  
23  integritetit të z. Kilaj.

24         Sot paradite neve na u tha, ne u vumë në dijeni të  
25  ekzistencën së materialeve që të mund të ketë ZPS-ja që mbase

1 mund të çojnë në kundërshtimin e kërkesës sipas rregullit 153,  
2 dhe në këto rrethana mund të duhet që një ose dy dëshmitarë të  
3 mund të paraqiten për t'u marrë pyetje nga Prokuroria.

4 Por, duke marrë parasysh kriteret sipas rregullit 153, i  
5 nderuar Gjykatës, ju e dini se është -- ka pas të ngjarë që  
6 këto dëshmitarë të vijnë të japin pyetje sepse këto janë  
7 dëshmitarë të cilët kanë të bëjnë me karakterin e të  
8 akuzuarit, dhe nuk ka të bëjë me sjelljen e të akuzuarit.

9 Por mbështetur në urdhrin tuaj për sa i takon kalendarit  
10 ose për sa i takon planifikimit të dëshmitarëve që do të mund  
11 të vijnë a të japin dëshmi në sallën e gjyqit, ne ju kërkojmë,  
12 i nderuar Gjykatës, që në qoftë se do të merrni parasysh  
13 kundërshtimin e ZPS-së, mund të na duhet që një ose dy  
14 dëshmitarë të vijnë dhe të japin dëshmi aty, por mund të  
15 ndodhë, për shembull, që dëshmitarët të japin dëshmi në  
16 distancë. Kështu që në qoftë se ju do të miratoni kërkesën e  
17 Prokurorisë atëherë do na duhet ne që të thërrasim një ose dy  
18 dëshmitarë për sa i takon karakterit të z. Kilaj.

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] E kuptoj që kjo kërkesë do  
20 të përfundojë plotësisht me 7 prill, apo jo? 7 prill 2026, apo  
21 jo? Kështu që unë sugjeroj që datat e 14 dhe 15 prillit të  
22 vazhdojnë dhe të planifikohen prej jush, domethënë, mund t'i  
23 marrim parasysh edhe për këtë arsye, për dëshmitarët tuaj të  
24 mundshëm, me kusht që t'i japim njoftim në kohë të  
25 dëshmitarëve. Pra, në qoftë se këta persona do të japin

1 dëshmi, do japin dëshmi përmes videolidhjes, z. Holmes, ju  
2 kuptova drejtë, apo jo?

3 Z. HOLMES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] I nderuar  
4 Gjykatës, dua ta konfirmoj me ta, por duam që ta mbajmë të  
5 hapur mundësinë që ata të mund të japin dëshmi në videolidhje,  
6 besojmë. Megjithatë, do të duhet ta konfirmojmë plotësisht me  
7 ta.

8 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka ndonjë koment Prokuroria  
9 lidhur me këtë?

10 Z. HAFETZ: [Përkthim] Shkurtimisht.

11 Dëgjuat parashtrime gjerë e gjatë lidhur me themelin e  
12 katër dëshmitarë. Nuk do i futem aspektit dhe debatit me  
13 Mbrojtjen sepse informacionet që kemi marrë neve mund të  
14 konsiderohen apo mund të kategorizohen thjeshtë si  
15 informacione njohjeje të thjeshta të këtyre dëshmitarëve me të  
16 akuzuarin. Megjithatë, në qoftë se do të shikojmë këta katër  
17 dëshmitarë për cilët ne jemi njoftuar të premtën, ne duam që  
18 t'i sjellim në vëmendje Gjykatës ca informacion që kemi  
19 zbuluar lidhur me to. Dhe ndoshta do të duhet që të kemi disa  
20 fakte të tjera për të cilat palët pajtohen përpara sesa të  
21 peshohet vlera e dëshmisë së tyre dhe përpara sesa të merret  
22 vendimi në qoftë se këto deklaratat janë të pranueshme apo jo.

23 E kuptoj plotësisht, pra, në qoftë se do të duhet që këta  
24 dëshmitarë të thërriten, që nuk më duhet me shumë gjasa për  
25 momentin, mendoj që datat që ju përcaktuat mjaftojnë për këta

1 dëshmitarë po ashtu.

2 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull, atëherë. I  
3 inkurajoj palët të konsultohen me njëri-tjetrin dhe të gjejnë,  
4 pra, gjuhën e përbashkët për të vijuar më tej lidhur me këtë  
5 aspekt.

6 Z. HOLMES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Falënderoj z.  
7 Hafetz lidhur me përpjekjet e tija dhe kjo pikërisht këtë gjë  
8 që bëri sot në mëngjes.

9 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka ndonjë gjë tjetër në  
10 këtë moment?

11 Po, z. Young.

12 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Së pari desha  
13 t'ju falënderoj për urdhrin gojor lidhur me praninë e z.  
14 Fazliu. Ju falënderoj për këtë. Ju falënderoj edhe për  
15 vendimin me shkrim pa hyrë në hollësi [REDAKTUAR]  
16 [REDAKTUAR].

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Diçka tjetër?

18 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Desha të flas për çështjen e  
19 verifikimeve të bëra nga Njësia e Përkthimit në përputhje me  
20 urdhrin tuaj ku përcaktohen afatet e ndryshme.

21 Ne kemi kërkuar nga Njësia e Përkthimit që të bëjë  
22 rishikimin e disa transkripteve të ZPS-së. Fillimisht kishim -  
23 - kemi kundërshtuar metodologjinë e ndjekur për të bërë këtë  
24 gjë dhe ju keni vendosur që Njësia e Përkthimit duhet të bëjë  
25 rishikimin e transkripteve të ZPS-së duke bërë verifikimin e

1 tyre. Ne kemi filluar tanimë të marrim rezultatet e këtij  
2 rishikimi.

3 Në këtë fazë, ne kemi -- qëndrojmë pranë parashtrimeve të  
4 bëra më herët sipas të cilave ne nuk pajtohemi me  
5 metodologjinë që ndiqet nga Njësia e Përkthimit, dhe, pra, ne  
6 nuk do të mbështetemi në punën që bëjnë ata, rezultatet e  
7 tyre. Pra, ua lemë juve, i nderuar Gjykatës, që të vendosni  
8 nëse duhet të vazhdohet ky proces i verifikime sipas kërkesave  
9 të bëra apo jo, por në këtë fazë ne nuk do t'i përdorim ato,  
10 me përjashtim të verifikimit që lidhet me vizitën e z. Kuçi.

11 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Do të pyes edhe palët e  
12 tjera nëse pajtohen me këtë parashtrim sepse ka dhe palë të  
13 tjera që janë të përfshira në disa prej këtyre kërkesave për  
14 transkripte të cilat, në fakt, janë duke u trajtuar.

15 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dhe që të  
16 theksoj për nevoja të procesverbalit, ne kemi respektuar  
17 afatin që ju keni urdhëruar për të ruajtur të drejtën tonë dhe  
18 fakti se sot ne po ju informojmë që nuk do të kërkojmë nga  
19 Njësia e Përkthimit që të plotësojë, të përmbyllë dhe të bëjë  
20 gjithë procesin e verifikimit të kërkuar. Nuk do të thotë që  
21 ne pajtohemi me transkriptet e ZPS-së. Ne mbajmë, vazhdojmë të  
22 kundërshtojmë ato. Thjesht ne nuk e konsiderojmë këtë proces  
23 si të nevojshëm për Mbrojtjen tonë.

24 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Që të jemi të qartë, a vlen  
25 kjo për secilën, për të gjitha transkriptet të cilat janë

1 aktualisht duke u rishikuar dhe verifikuar nga Njësia e  
2 Përkthimit?

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Për sa na takon neve.  
4 Megjithatë, siç e thashë, e bëra me dije, ne jemi të  
5 interesuar të dimë të njohim rezultatet e procesit të  
6 rishikimit për materialet që kanë të bëjnë me z. Kuçi, pra,  
7 vizitën e z. Kuçi.

8 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Pra nuk është -- për këtë  
9 nuk tërhiqeni, për këtë pjesë të transkriptit, është e saktë?

10 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Kështu është.

11 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po kërkoni që të tërhiqni  
12 kërkesën tuaj për transkriptet e tjera?

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Duke qenë se na duhet të  
14 paraqesim si prova këto materiale, ne po ua lemë juve të  
15 vendosni nëse ky proces është i nevojshëm. Në këtë fazë ne nuk  
16 bëjmë më -- duam që kërkesa jonë të vijojë të trajtohet nga  
17 kjo njësi.

18 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Sepse ka disa kërkesa që  
19 janë bërë në mënyrë të përbashkët, znj. Menegon, dhe duhet të  
20 konsultoj edhe të pandehurit e tjerë të cilët kanë parashtruar  
21 kërkesa të përbashkëta për verifikim të të njëjtave  
22 transkripte.

23 A mund të sugjeroj që kjo çështje -- të që konsultoheni,  
24 pra, jashtë sallës së gjyqit dhe pastaj të vini me një qëndrim  
25 lidhur me verifikimet nëse duhet të vijohet më tej me

1 verifikimet, me këto verifikime apo që t'i komunikojmë Zyrës  
2 Administrative apo Dhomës që të -- përmes Zyrës  
3 Administrative?

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Në rregull, Gjykatës, do të  
5 bëjmë një gjë të tillë.

6 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka ndonjë gjë tjetër për  
7 t'u ngritur? Jo.

8 Seanca ndërpritet deri më 14 prill, në orën 9.30, përveç  
9 në qoftë se merret njoftim tjetër nga ana jonë.

10 Faleminderit.

11 --- Seanca mbyllet në orën 14.55

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25